



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada – Government

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë - Ministarstva Obrazovanja Nauke i
Tehnologije -Ministry of Education Science &Technology*

Kabineti i Ministrit /Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), në mbështetje të nenit 145 pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, nenit 20, paragrafi 1 të Ligjit për arsimin parauniversitar (Gazeta Zyrtare nr. 17, 2011), duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dt. 22.03.2011, nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Për standardet e praktikës profesionale të drejtorëve të shkollës

NUMËR: 04/2012

DATË: 02.05.2012

Neni 1 Qëllimi

Ky Udhëzim administrativ specifikon standardet e praktikës profesionale të drejtorëve të shkollave (standardet në vijim të këtij dokumenti).

Neni 2 Definicionet

1. Standardet – indikatorët e matshëm të arritjes, të definuar qoftë në kritere kualitative apo kuantitative që duhet të arrihen nga kandidatë të caktuar.
2. Drejtori – kryesuesi i një institucioni arsimor ose aftësues.
3. Menaxherë shkollash – drejtorët ose personeli tjetër i ngarkuar me përgjegjësi administrative dhe menaxhuese brenda shkollës.

Neni 3 Qëllimi dhe përdorimi i standardeve

1. Këto standarde do të shfrytëzohen për qëllimet në vijim:
 - 1.1. Pikë referimi për politikën dhe praktikën e punësimit të menaxherëve të shkollave;
 - 1.2. Pikë referimi për politikën dhe praktikën e zhvillimit profesional të menaxherëve të shkollave, duke përfshirë:
 - 1.2.1. Zhvillimin e programeve të zhvillimit profesional për menaxherët e shkollave;
 - 1.2.2. Akreditimin e programeve për zhvillim profesional të menaxherëve të shkollave;
 - 1.2.3. Vlerësimin e programeve të zhvillimit profesional të menaxherëve të shkollave.
 - 1.3. Pikë referimi për sistemin dhe instrumentet e vlerësimit të performancës së menaxherëve të shkollave.
 - 1.4. Instrument për vetëzhvillimin e menaxherëve të shkollave:
 - 1.4.1. Instrument reflektimi për praktikën profesionale të menaxherëve të shkollave;
 - 1.4.2. Instrument vetëvlerësimi për menaxherët e shkollave

Neni 4 Standardet

1. Standardi i 1- Udhëheqja dhe Motivimi- Drejtori i shkollës e nxit suksesin e shkollës dhe të nxënësve të saj duke mundësuar zhvillimin, artikullimin dhe zbatimin e një vizioni të nxënies të reflektuar në vlerat, misionin dhe objektivat e përbashkëta shkollore dhe mësimdhënien në klasë.
 - 1.1. Drejtori i shkollës duhet të ketë njohuri dhe të kuptojë:
 - 1.1.1. Kornizën e Kurrikulumit të Kosovës;
 - 1.1.2. Krijimin e një vizioni, misioni dhe objektive të shkollës;
 - 1.1.3. Zhvillimin dhe zbatimin e planit strategjik dhe planit shkollor vjetor;
 - 1.1.4. Strategjitë për ngritjen e bashkëpunimit;
 - 1.1.5. Zhvillimin organizativ;
 - 1.1.6. Procesin e ndryshimit të sistemeve, organizatave dhe individëve;
 - 1.1.7. Mjetet për planifikim, duke përfshirë analizën SWOT;
 - 1.1.8. Praktikën efektive të udhëheqjes;
 - 1.1.9. Komunikimin efektiv;
 - 1.1.10. Analizimin dhe përdorimin e të dhënave në vendimmarrje duke respektuar nxënien;
 - 1.1.11. Transparencën dhe llogaridhënien.

1.2. Treguesit e performancës. Drejtori i shkollës, për ta arritur këtë standard, kryen aktivitetet në vijim:

1.3. Komunikon dhe udhëhiqet nga një filozofi arsimore e bazuar mbi hulumtime akademike, përvojë personale dhe reflektim;

1.4. Përfshin komunitetin shkollor (me një barazi të njëjtë gjinore dhe të minoriteteve etnike të mësimdhënësve, prindërve, nxënësve dhe komunitetit) në zhvillimin e planit strategjik dhe planit vjetor të punës;

1.5. Zhvillon dhe menaxhon procedurat e veprimit të lidhura me planin e shkollës, për t'i shfrytëzuar më së miri mundësitë për nxënie të suksesshme;

1.6. Përdorë të dhënat e rëndësishme demografike që kanë të bëjnë me nxënësit dhe familjet e tyre në zhvillimin e misionit dhe objektivave të shkollës;

1.7. Komunikon në mënyrë efektive vizionin dhe misionin e shkollës tek personeli, prindërit, nxënësit dhe anëtarët tjerë të komunitetit;

1.8. Siguron që vizioni, misioni dhe planet për zbatim rregullisht të monitorohen, vlerësohen, dhe rishikohen sipas nevojës;

1.9. I identifikon, i qartëson dhe i adreson pengesat, duke i përfshirë edhe ato shoqërore, për arritjen e vizionit;

1.10. Siguron që planifikimi, vendimmarrja dhe zbatimi i strategjive të jenë të bazuara në një vizion të përbashkët dhe në të kuptuarit e kulturës së shkollës;

1.11. Mundëson ndryshim dhe inkurajon risi në përputhje me nevojat e komunitetit të shkollës, sot dhe në të ardhmen;

1.12. Analizon një spektër të gjerë të të dhënave (duke përfshirë sipas nevojës edhe të dhënat e ndara sipas gjinisë) për ta përcaktuar zhvillimin drejt arritjes së objektivave të shkollës duke përfshirë të dhënat e vlerësimit që lidhen me nxënien;

1.13. I komunikon dhe i përgëzon të arriturat e shkollës për të frymëzuar një rritje të vazhdueshme;

1.14. Raporton tek personeli, këshilli drejtues i shkollës, komuniteti dhe autoritetet komunale në lidhje me nivelin e përmbushjes së planeve vjetore dhe strategjike të shkollës.

2. Standardi i dytë (2) Mësimdhënia dhe nxënia cilësore- Drejtori i shkollës siguron që të gjithë nxënësit të kenë qasje të vazhdueshme në mundësitë për mësimdhënie dhe nxënie cilësore përmes zhvillimit të një kulture shkollërore e cila vlerëson dhe mbështetë mundësi të barabarta për nxënie të nxënësve dhe ngritje profesionale të personelit.

2.1. Njohuritë: Drejtori i shkollës duhet të ketë njohuri dhe të kuptojë:

2.1.1. Ngritjen dhe zhvillimin e nxënësve;

2.1.2. Nxënësit me nevoja të veçanta dhe programin e arsimit të tyre;

2.1.3. Nxënien për të rritur;

2.1.4. Modelet e ngritjes profesionale të personelit;

2.1.5. Format e nxënies, menaxhimin e klasës dhe metodat e teknikat e mësimdhënies;

2.1.6. Motivimin për nxënie;

2.1.7. Zbatimin, adaptimin, plotësimin dhe vlerësimin e kurrikulumit;

2.1.8. Parimet e të udhëzuarit efektiv;

2.1.9. Matjen dhe vlerësimin; Vlerësimin për të nxënit dhe Vlerësimin e të nxënit;

2.1.10. Shumëllojshmërinë dhe ndikimin e saj në programet arsimore;

2.1.11. Rolin e teknologjisë në përmirësimin e nxënies dhe ngritjes profesionale të personelit;

2.1.12. Motivimin për nxënien për të rritur – personeli dhe prindërit;

2.1.13. Barazinë gjinore dhe çështjet e trajtimit të drejtë në sistemin arsimor në Kosovë.

2.2. Treguesit e performancës. Drejtori i shkollës, për ta arritur këtë standard, kryen aktivitetet në vijim:

- 2.2.1** Mbështetë dhe mundëson ngritje të plotë profesionale për mësimdhënësit, prindërit dhe të tjerët, me një vëmendje të veçantë tek nxënia në përputhje me vizionin dhe objektivat e shkollës;
- 2.2.2** I identifikon, i qartëson, dhe i adreson sfidat në nxënie duke i përfshirë edhe ato çështje që bazohen në kontekstin gjinor;
- 2.2.3.** Siguron që nxënësit me nevoja të veçanta të marrin pjesë në programe të përshtatshme;
- 2.2.4.** Inkurajon dhe modelon nxënien gjatë gjithë jetës për nxënësit dhe personelin;
- 2.2.5.** Inkurajon një kulturë pritjesh të mëdha për nxënësit dhe personelin;
- 2.2.6.** Përshtat dhe zbaton programe kurrikulare, ndërkurrikulare, dhe jashtëkurrikulare të cilat janë të disponueshme për të gjithë nxënësit në mënyrë të barabartë;
- 2.2.7.** Zbaton strategjitë për shfrytëzimin e të dhënave mbi të arriturat e nxënësve të ndara sipas gjinisë;
- 2.2.8.** Siguron që praktikatat e vlerësimit të nxënësve në mbarë shkollën të jenë të drejta, të përshtatshme dhe të balancuara;
- 2.2.9.** Siguron që pedagogia e duhur është shfrytëzuar si përgjigje ndaj aspekteve të ndryshme të shumëllojshmërisë së nxënësve;
- 2.2.10.** Shfrytëzon burime të ndryshme të informatave për vendimet të cilat ndikojnë në mirëqenien e nxënësve në shkollë;
- 2.2.11.** Njeh mundësitë e teknologjisë së re dhe asaj në zhvillim, dhe bën të mundur integrimin e tyre të plotë në mbështetje të mësimdhënies dhe të nxënies.

3. Standardi i tretë (3) Planifikimi dhe Menaxhimi- Drejtori i shkollës menaxhon shkollën, aktivitetet dhe burimet e shkollës për tu siguruar se ofrohet një mjedis i sigurt, i shëndetshëm dhe për një nxënie efektive.

3.1. Njohuritë: Drejtori i shkollës duhet të ketë njohuri dhe të kuptojë:

3.1.1. Praktikatat, parimet dhe çështjet e menaxhmentit që lidhen me:

3.1.1.1 menaxhimin financiar të shkollës;

3.1.1.2 kujdesin dhe përdorimin e hapësirave të shkollës;

3.1.1.3 sigurinë në shkollë.

3.1.2. Procedurat e veprimit në nivelin e shkollës, në nivelin komunal dhe atë kombëtar;

3.1.3 Menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore;

3.1.4 Teknologjitë bashkëkohore që mbështesin funksionet e menaxhimit.

3.2. Treguesit e performancës:

3.2.1 Drejtori i shkollës, për ta arritur këtë standard, kryen aktivitetet në vijim:

3.2.1.1 Në mënyrë efektive planifikon, organizon dhe menaxhon burimet njerëzore, fizike dhe financiare të shkollës dhe identifikon nevojat e saj;

3.2.1.2 Siguron që vizioni, misioni dhe objektivat e shkollës t'i udhëheqin vendimet e menaxhmentit dhe organizimin e nxënies;

3.2.1.3 Menaxhon kohën për t'i arritur objektivat organizative;

3.2.1.4 Identifikon problemet e mundshme dhe mundësitë;

3.2.1.5. Siguron që hapësira shkollore, pajisjet dhe sistemet mbështetëse të funksionojnë në mënyrë të sigurt, efektive dhe efikase;

3.2.1.6. Përdor në mënyrë efektive dhe efikase burimet e disponueshme financiare dhe asetet për të përmirësuar rezultatet e të nxëniet;

3.2.1.7. Planifikon dhe udhëheq një sistem efektiv të planifikimit të buxhetit duke u bazuar në planet shkollore strategjike dhe vjetore në bashkëpunim me këshillin e shkollës;

3.2.1.8. Krijon dhe mban një mjedis shkollor të sigurt, të pastër dhe miqësor;

3.2.1.9. Përdor teknologjinë në menaxhimin e shkollës.

4. Standardi 4: Bashkëpunimi dhe ndërveprimi- Drejtori i shkollës krijon marrëdhënie të qëndrueshme me komunitetin e shkollës, nxënësit, mësimdhënësit, prindërit, këshillin drejtues të shkollës dhe palët e tjera të interesit dhe inkurajon udhëheqje të përbashkët në përputhje me interesat e nxënësve të këtij komuniteti.

4.1. Njohuritë:Drejtori i shkollës duhet të ketë njohuri dhe të kuptojë:

4.1.1. Ndikimin e prindërve në nxënie;

4.1.2. Rolin dhe ndikimin e prindërve, këshillit të shkollës dhe DKA-së në aktivitetet e shkollës;

4.1.3. Përdorimin e burimeve të prindërve dhe komunitetit;

4.1.4. Marrëdhëniet me komunitetin dhe strategjitë e komunikimit;

4.1.5. Modelet e suksesshme të partneritetit në mes shkollës, familjes, biznesit, komunitetit, qeverisë dhe institucioneve arsimore;

4.1.6. Shkathtësitë në zgjidhjen e problemeve.

4.2. Treguesit e performancës: Drejtori i shkollës, për ta arritur këtë standard, kryen aktivitetet në vijim:

4.2.1. Angazhon prindërit në mënyrë proaktive që ata të përfshihen në edukimin e fëmijëve të tyre dhe në jetën e shkollës;

4.2.2. Ndanë përgjegjësinë me personelin, nxënësit dhe komunitetin për ta fuqizuar pronësinë dhe llogaridhënien;

4.2.3. Mbështet përdorimin e burimeve të prindërve dhe komunitetit për ta avancuar mësimdhënien dhe nxënien;

4.2.4. Është i vetëdijshëm dhe i sensibilizon të tjerët për zhvillimet e reja që mund të ndikojnë në shkollë dhe komunitet;

4.2.5. Siguron që të gjithë nxënësit dhe personeli të ndjehen të vlerësuar dhe të rëndësishëm;

4.2.6. Angazhon komunitetin e shkollës në identifikimin dhe adresimin e fushave për përmirësimin e shkollës;

4.2.7. Siguron që mësimdhënësit dhe personeli tjetër të komunikojnë dhe të bashkëpunojnë me prindërit dhe anëtarët e komunitetit sipas nevojës, për ta mbështetur nxënien;

4.2.8. Krijon marrëdhënie të një respekti të ndërsjellë me anëtarët e këshillit të shkollës dhe u siguron atyre informata të nevojshme për t'i përmbushur rolet e tyre;

4.2.9. Merr vendime në bazë të nevojave dhe pritjeve të komunitetit të shkollës;

4.2.10. Tregon kujdes për të tjerët dhe kultivon një klimë të respektit të ndërsjellë me të gjithë anëtarët e komunitetit të shkollës;

4.2.11. Krijon partneritete me bizneset lokale dhe institucionet arsimore për t'i fuqizuar programet dhe për t'i mbështetur objektivat e shkollës;

4.2.12. Komunikon në mënyrë të duhur me nxënësit, personelin, prindërit dhe komunitetin;

4.2.13. Krijon dhe mban raporte të qëndrueshme me mediat dhe palët e interesit;

4.2.14. E inkurajon punën në ekip dhe udhëheqjen e ndarë në mes të anëtarëve të shkollës-komunitetit;

4.2.15. Identifikon dhe këshillon mësimdhënësit për rolet e udhëheqjes në të ardhmen;

4.2.16. Pranon përgjegjësitë dhe kontributet e secilit individ;

4.2.17. Përdor shkathtësi efektive në zgjidhjen e problemeve.

5. Standardi 5: Legjislacioni dhe Shoqëria- Drejtori i shkollës i kupton dhe vepron me përgjegjësi ndaj konteksteve politike, shoqërore, ekonomike, ligjore dhe kulturore që ndikojnë në shkollë.

5.1. Njohuritë: Drejtori i shkollës duhet të ketë njohuri dhe të kuptojë:

5.1.1. Ligjet dhe rregulloret mbi arsimin në Kosovë (duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me aspektin gjinor);

5.1.2. Politikat e rëndësishme të komunave;

5.1.3. Rolin e arsimit në zhvillimin e demokracisë;

5.1.4. Proceset politike, shoqërore, kulturore dhe ekonomike që ndikojnë në shkolla;

5.1.5. Arsyeshmërinë e politikave kombëtare në arsim në lidhje me vlerat dhe aspiratat e komunitetit;

5.1.6. Proceset e konsultimit, ndërmjetësimit dhe zgjidhjes së problemeve;

5.1.7. Zhvillimet globale që ndikojnë në mësimdhënie dhe nxënie.

5.2. Treguesit e performancës: Drejtori i shkollës, për ta arritur këtë standard kryen aktivitetet në vijim:

5.2.1. Përcjellë zhvillimet lokale, kombëtare dhe globale lidhur me arsimin;

5.2.2. Mban komunikim të vazhdueshëm për çdo çështje që ka të bëjë me politikat kombëtare apo komunale dhe aspiratat e komunitetit për shkollën duke përfshirë ndryshimet në mjedisin në të cilin vepron shkolla;

5.2.3. Mban komunikim të vazhdueshëm me palë të ndryshme të interesit;

5.2.4. Avokon për mbështetjen e komunitetit për shkollë dhe sistem më të gjerë të arsimit;

5.2.5. Siguron që shkolla të punojë brenda kornizës së politikave, ligjeve dhe rregulloreve të miratuara nga autoritetet lokale dhe shtetërore.

6. Standardi 6- Etika profesionale- Drejtori i shkollës vepron me integritet, drejtësi dhe etikë të lartë.

6.1. Njohuritë: Drejtori i shkollës duhet të ketë njohuri dhe të kuptojë:

6.1.1. Qëllimin e arsimit dhe rolin e udhëheqjes në shoqërinë moderne;

6.1.2. Parimet dhe praktikat e përfshirjes brenda shkollës dhe komunitetit të shkollës;

6.1.3. Kornizat e ndryshme etike dhe perspektivat e etikës;

6.1.4. Vlerat e shkollës-komunitetit të shumëllojshëm;

6.1.5. Kodet profesionale të etikës.

6.2. Treguesit e performancës: Drejtori i shkollës, për ta arritur këtë standard kryen aktivitetet në vijim:

6.2.1. Shqyrton vlerat e tij personale dhe profesionale;

6.2.2. Shërben si model duke:

6.2.3. Pasqyruar një kod personal dhe profesional të etikës;

6.2.4. Pasqyruar vlerat, besimet dhe qëndrimet që frymëzojnë të tjerët të arrijnë në nivele më të larta të performancës;

6.2.5. Pranuar përgjegjësinë për veprimet e shkollës;

6.2.6. Njohur përvojat e mira të të tjerëve;

6.2.7. Trajtuar të gjithë njerëzit në mënyrë të drejtë, të barabartë, me dinjitet dhe respekt;


6.2.8. Mundësuar qasje për të gjithë fëmijët pavarësisht nga vështirësitë fizike apo intelektuale, gjinore, racore, fetare apo të statutit shoqëror;

6.2.9. Analizuar dhe duke pasur parasysh vlerat përbrenda shkollës-komunitetit të shumëllojshëm;

- 6.2.10. Përdor ndikimin e pozitës për të përmirësuar cilësinë e mësimin e jo për përfitime personale;
- 6.2.11. Mbron të drejtat dhe privatësinë e nxënësve dhe personelit;
- 6.2.12. E njeh dhe respekton autoritetin legjitim të të tjerëve;
- 6.2.13. Ndikon tek anëtarët e tjerë të komunitetit të shkollës që të demonstrojnë integritet dhe të ushtrojnë sjellje etike;
- 6.2.14. Siguron që shkolla të jetë publikisht e përgjegjshme;
- 6.2.15. Përbush obligimet ligjore dhe zbaton ligjet dhe procedurat në mënyrë të drejtë;
- 6.2.16. Siguron proces transparent dhe të drejtë në përzgjedhjen e nxënësve, mësimdhënësve dhe të tjerëve si përfaqësues të shkollës në aktivitete, ngjarje apo për mundësi të ngritjes profesionale.

Neni 5 Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga ministri.


Prof. dr. Ramë Buja, ministër

